



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË - KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO POLJE



Ekstrakt nga procesverbali, mbledhja e gjashtë - VI, e rregullt, e mbajtur më datë 29.06.2017, ora 10:00h, në Sallën e Kuvendit të Komunës.

Prezentë në mbledhje ishin anëtarët e Kuvendit të Komunës: Fadil Krasniqi - Kryesues i Kuvendit të Komunës, Qerim Gara - Zëvendëskryesues i Kuvendit të Komunës për Komunitete, Nazmi Kelmendi, Milaim Berjani, Remzi Shala, Bastri Sllamniku, Bedri Krasniqi, Sabit Bullatovci, Sabri Rexhepi, Shaban Ademi, Vjollca Konjusha, Mirishahe Berisha, Arjeta Jashari, Naser Graiçevci, Ridvan Krasniqi, Fazile Sejdiu, Aida Alimi, Sabit Godeni, Migjen Kolshi, Hasan Krasniqi, Trandolina Duli, Ali Ismaili, Fitore Simnica, Ylber Islami, Elmi Shabani dhe Miroslav Veličković.

Mungon: Sazana Statovci.

Kryetari i Komunës dhe Drejtorët e Drejtorive të Komunës: Jakup Dumani - Nënkryetar i Komunës, Halil Qerimi - Nënkryetar i Komunës për Komunitete, Nuriye Fazliu - Drejtore e Administratës, Ramadan Jashanica - Drejtor i Financave dhe Buxhetit, Abdullah Prebreza - Drejtor i Planifikimit Urban, Jakup Tërnavë - Drejtor i Gjeodezisë, Kadastrit dhe Pronës, Nuriye Avdiu - Drejtore e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Maliq Berisha - Drejtor i Shërbimeve Publike dhe Mjedisit.

Të tjerë: Përfaqësuesit e KFOR-it dhe qytetarë.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës përshëndeti të pranishmit në mbledhje, pas verifikimit të prezencës së anëtarëve të Kuvendit të Komunës, konstatoi se ekziston kuorumi për mbajtjen e mbledhjes dhe prezantoi këtë:

REND DITE

1. Aprovimi i ekstrakteve të procesverbaleve nga mbledhjet e Kuvendit të Komunës, të datave: 31.03.2017, 28.04.2017 dhe 23.05.2017.
2. Pyetje dhe përgjigje parlamentare.
3. Propozim për shqyrtimin e Raportit Financiar për buxhetin e shpenzuar janar - mars të vitit 2017.
4. Propozim për shqyrtimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore 2018-2020.
5. Propozim për konfirmimin e vlefshmërisë së Rregullores për Tatimin në Pronën e Paluajtshme për vitin 2018.
6. Propozim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Palestrës Sportive.
7. Propozim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Sallës së Sporteve për 'Arte Marciale'.
8. Propozim për ndërrimin e destinimit të pronës për ndërtimin e 'Qendrës rekreativo-sportive' në fshatin Miradi e Epërme.
9. Shqyrtimi i parë i Projekt-Planit Zhvillimor të arsimit 2017-2019.

10. Shqyrtimi i kërkesës së Shoqatës 'Trojet tona' për lejin e dhënies në shfrytëzim të një zyreje në objektin e Shtëpisë së Kulturës në Fushë-Kosovë.
11. Propozim për shyrimin e kërkesës, Nr. 020-744/3, të datës 02.06.2017, për vendimin Nr. 81, të datës 15.05.2017 për lejin e ndërtimit të lartë në Fushë-Kosovë.
12. Propozim për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore, në tokë ndërtimore për subjektin afarist 'Xini Invest' në fshatin Harilaç.
13. Propozim për ndryshimin e vendimit, Nr. 76, të datës 08.05.2017, për subjektin afarist 'Princi Kompani' në fshatin Harilaç.
14. Propozim për shqyrtimin e kërkesës për ndryshimin e etazhitetit nga banimi individual, në ndërtim të lartë në Fushë-Kosovë.
15. Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës kërkoj nga anëtarët e Kuvendit të Komunës që të deklarohen për rendin e ditës së propozuar dhe pikën shtesë: 'Propozimin për ndryshimin e Planit Zhvillimor Urban dhe Planit Rregullues Urban, lidhur me ndryshimin e etazhitetit nga banimi individual, në ndërtim të lartë në Fushë-Kosovë'. Hap diskutimin.

Naser Graiçevci: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Rendi i ditës për mbledhjet e Kuvendit të Komunës po formulohet dhe përgatitet nga një rreth i ngushtë, pa lejuar që të shqyrtohen kërkesat e qytetarëve, kjo punë është shndërruar në një çështje teknike për pushtetin! Kërkesa e opozitës për: 'Devijimet në qeverisjen komunale', nuk pranohet të shqyrtohet dhe debatohet në Kuvendin e Komunës! Po ashtu, kërkoj që të shqyrtohet edhe kërkesa e banorëve të rrugës 'Naim Sylja' për asfaltimin e një pjese të shkurtër të rrugës së tyre, ata kërkesën e kanë dorëzuar edhe në Drejtorinë e Planifikimit Urban, por ajo nuk po merret parasysh! Dua të them se Kryesuesi i Kuvendit të Komunës dhe Ekzekutivi i Komunës, kërkesat e Partisë Demokratike të Kosovës për debat nuk po i marrin parasysh, andaj në këtë frymë ne jemi kundër rendit të ditës, por do të jemi pjesëmarrës në mbledhje për arsye të rëndësishme të pikave të rendit të ditës që do të shqyrtohen. Kërkoj që pikat e ngritura nga ne për shqyrtim të jenë pjesë e rendit të ditës për mbledhjen e ardhshme. Dua t'i falënderoj qytetarët e komunës tonë dhe partitë politike për kulturën demokratike të treguar në zgjedhjet e këtij muaji dhe uroj që kjo frymë e tillë demokratike të jetë në vazhdimësi.

Ylber Islami: Në Kuvendin e Komunës tonë mungon edhe zërimi - ka problem, audioincizimi i mbledhjeve për qytetarë nuk lejohet nga Ekzekutivi i Komunës, shqyrtohen pika të rendit të ditës shumë serioze nga urbanizmi, merren vendime pa sqarime konkrete, shkelet Rregullorja e Punës së Kuvendit të Komunës!

Pas sqarimeve, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës e qiti në votim për aprovim rendin e ditës së propozuar me pikën shtesë: 'Propozimin për ndryshimin e Planit Zhvillimor Urban dhe Planit Rregullues Urban lidhur me ndryshimin e etazhitetit nga banimi individual, në ndërtim të lartë në Fushë-Kosovë'.

U votua me: shtatëmbëdhjetë vota 'për', shtatë 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej njëzet e katër (24) anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës, me shumicë të votave, e aprovoi për shqyrtim rendin e ditës së propozuar dhe pikën shtesë: 'Propozimin për ndryshimin e Planit Zhvillimor Urban dhe Planit Rregullues Urban, lidhur me ndryshimin e etazhitetit nga banimi individual, në ndërtim të lartë në Fushë-Kosovë'.

Pika e parë (1) - Aprovimi i ekstrakteve të procesverbaleve nga mbledhjet e Kuvendit të Komunës, të datave: 31.03.2017, 28.04.2017 dhe 23.05.2017.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Theksoj se i kemi për aprovim ekstraktet e procesverbaleve nga tre mbledhjet e kaluara. Hap diskutimin.

Nazmi Kelmendi: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Në emër të anëtarëve të Grupit Parlamentar të LDK-së theksoj se ekstraktet e procesverbaleve nga mbledhjet e Kuvendit të Komunës, të mbajtura më datë: 31.03.2017, 28.04.2017 dhe 23.05.2017, përmbajnë esencën e të gjitha diskutimeve të mbledhjeve. Nuk kemi ndonjë vërejtje apo sugjerim, andaj propozojmë që të aprovohen, me inkorporimin eventual të vërejtjeve të secilit anëtarë për diskutimin e tij.

Trandolina Duli: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Unë do të shpreh këtu qëndrimin tonë që e kemi përsëritur çdo herë në këtë legjislaturë. Ne jemi kundër aprovimit të ekstrakteve të procesverbaleve, meqë nuk po respektohet Ligji për Vetëqeverisjen Lokale, Statuti i Komunës dhe Rregullorja për Punën e Kuvendit të Komunës. Kërkojmë që ekstraktet e procesverbaleve të votohen ndaras, e jo në bllok.

Naser Graiçevci: Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së jemi kundër aprovimit të ekstrakteve të procesverbaleve, meqë nuk po shohim asnjë arsye që pushteti aktual të reflektojë, në vazhdimësi po shkelet ligji dhe Rregullorja e Punës, nuk publikohen audioincizimet e mbledhjeve.

Pasi që diskutime dhe plotësime tjera nuk pati, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës ftoi anëtarët e Kuvendit të Komunës që të votojnë për aprovimin e ekstrakteve të procesverbaleve nga mbledhjet e Kuvendit të Komunës, të mbajtura më datë: 31.03.2017, 28.04.2017 dhe 23.05.2017.

U votua me: gjashtëmbëdhjetë vota 'për', nëntë 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej njëzet e pesë (25) anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës, me shumicë të votave, i aprovoi ekstraktet e procesverbaleve nga mbledhjet e datës: 31.03.2017, 28.04.2017 dhe 23.05.2017.

Pika e dytë (2) - Pyetje dhe përgjigje parlamentare.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi pikën 'Pyetje dhe përgjigje parlamentare', ftoj anëtarët e Kuvendit të Komunës që ta marrin fjalën, nëse kanë pyetje të reja për Ekzekutivin e Komunës.

Ylber Islami: Publikimet nuk ndodhin, ekstraktet e procesverbaleve, audioincizimet, mungon transparenca, komuna e ka hierarkinë e vet - Kryesuesin e Kuvendit të Komunës, opinionin është i përjashtuar nga informimi për shkak të një njeriu absolut që nuk lejon të publikohen audioincizimet, çfarë ndodh këtu, audioincizimet mbyllen për katër vjet radhazi, a ka shkelje, çfarë diskutohet në Kuvendin e Komunës, qytetari i komunës nuk ka përgjigje!

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Ju lutem mos analizoni dhe mos komentoni, parashtroni pyetjet tuaja konkrete për Ekzekutivin e Komunës.

Ylber Islami: Çështje tjera që lidhen me Inspektoratin e Komunës! Unë e kam bërë një petition, në bashkëpunim me qytetarët e zonës, atë e kam dorëzuar zyrtarisht në komunën tonë, në Komunën e Obiliqit dhe në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, por nuk kam marrë asnjë përgjigje për operimin e gurthyesit në Nakarad, ky është një 'akt kriminal', Ministria, Komunitat a operon ky gurthyes, pa leje pune, e ndotë vendin dhe ambientin!? Madje këtë fakt si vendin më të ndotur e ka përmendur edhe vetë ish/Presidenti Amerikan - Obama, në profilin dhe shkrimin e tij. Ky operator ekonomik, a operon në dy komuna, cilat janë përgjegjësitë e tyre për veprim? Lidhur me këtë çështje, herët a vonë, do të jepni përgjegjësi, 'para zotit dhe para ligjit', sepse aty po shkatërrohet jeta e qytetarëve! Nakardës i mungon çerdhja, shkolla, ambulanca, por aty i dhurohet qytetarëve një deponi e egër, pluhur, materiale inerte! Për Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Mjedisit e kam një pyetje, a mund të intervenohet në rregullimin e rrjetit të kanalizimit në lagjen e 'Mirenëve', ku nga një gyp i dëmtuar po dalin ujërat e zeza në rrugë? Pyes, a ka mundësi të intervenohet në sanimin e gjendjes aty? Raportet financiare për Organizatat Joqeveritare nuk vijnë asnjëherë, për Bashkësinë Islame, për Klubin e Futbollit 'Fushë-Kosova', për Shoqatën Bamirëse 'Nënë Tereza', pastaj, kam informata se paguhen qira për banim në emër të komunës, ne nuk e kemi asnjë raport financiar për këto shpenzime të parasë publike! Nuk vjen Raporti Financiar as për 'KARITAS-in', kush janë të punësuarit, cila është gjendja e klubeve sportive, futbolli luhet sikur në livadhe?! Në rrugën e çerdhes automjetet me pesha të rënda zhvillojnë shpejtësi deri në 100 km në orë, ngritet pluhuri, si të ishim në Saharë! Ku shkojnë këta kamionë, pse nuk intervenon komuna me vendosjen e policëve të shtrirë nëpër disa rrugë të qytetit? Një pjesë e madhe e qytetit, prej shkollës e deri te hekurudha, nuk ka ujë, me muaj të tërë, askush nga ata që janë përgjegjës nuk intervenon!

Aida Alimi: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Unë do të paraqes për zgjidhje këtu kërkesën e banorëve të rrugës 'Naim Sylja', e cila është bërë që nga viti 2015 dhe 2016. Në fakt ata i kanë tre kërkesa shtruarjen e rrugës me zhavorr në fillim, pastaj asfaltimin e saj, ajo rrugë i ka 600 metra, ndërsa janë asfaltuar vetëm 130 metra, ku është avulluar pjesa tjetër e rrugës? Ne e kemi edhe petitionin e nënshkruar nga 101 qytetarë, për zgjidhjen e këtij problemi për banorët.

Naser Graiçevci: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Tani përfundoi Festa e Bajramit të Madh, kur njerëzit i vizitojnë varrezat e qytetit, gjendja e tyre është e mjerë, bari është rritur, shumica e varrezave edhe nëpër fshatra tjerë janë në të njëjtën gjendje, hiç këtu fshatin Miradi e Poshtme. Ne po ndajmë para për mbulimin e shpenzimeve të varrimit, andaj duhet ta kemi edhe një kujdes të shtuar për varreza! E njëjta gjendje është edhe te varrezat e komunitetit serb, aty hedhen mbeturina, kjo nuk është mirë, komuna duhet të bëjë pastrimin e varrezave dhe të vendosë mbishkrimin e saj, se: 'këtu nuk lejohet hedhja e mbeturinave', duhet të ruhet paraja publike! Ne jemi në dijeni se sot bëhet pastrimi pastaj hedhen mbeturina, duhet të jetë aty një numër i telefonit për lajmërim. Çështjet duhet të adresohen, të vëhen në funksion mekanizmat e ligjit, kjo është një kërkesë për Ekzekutivin e Komunës, duhet të dihet kur pastrohet një deponi e egër nga organet e shtetit.

Drejtori i SHPM-së: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Edhe ne jemi të shqetësuar për eliminimin e deponive të egra, i kemi pastruar disa herë, por prapë hedhen mbeturina, ne jemi të pakënaqur me këtë dukuri, tani është në proces sinjalizimi horizontal dhe vertikal i rrugëve dhe do t'i vendosim disa shenja identifikuese rreth 150, disa prej këtyre shenjave duhet ta kenë mesazhin e tyre apelues për qytetarë dhe këtu përfundon ky proces, ne nuk mund ta kemi rolin e Policisë së Shtetit. Sa i përket furnizimit me ujë të pijshëm edhe ne jemi të shqetësuar, por kërkesat tona për zgjidhje po hasin në veshë të shurdhër, kjo është e vërteta, ne e kemi adresuar problemin të Kompania Rajonale e Ujësjellësit Prishtina.

Remzi Shala: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Pyes, a ka komuna plan për dezinfektimin e ambientit, sepse tani jemi në verë dhe temperaturat janë të larta, rritet numri i mushkonjave dhe insekteve tjera, kur do të bëhet dezinfektimi i ambientit?

Pika e tretë (3) - Propozim për shqyrtimin e Raportit Financiar për buxhetin e shpenzuar janar - mars të vitit 2017.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim 'Propozimin për shqyrtimin e Raportit Financiar për buxhetin e shpenzuar janar - mars 2017', ftoj Drejtorin e Financave dhe Buxhetit që të na jap sqarime.

Drejtori i FB-së: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Shkak për vonesën e 'Raportit tremujor për buxhetin e shpenzuar', është vonesa në alokimin e buxhetit nga Ministria e Financave, andaj i kemi paraqitur shpenzimet vetëm në formën sintetike, për arsye se ka patur pak shpenzime. Në raportin gjashtëmujor për buxhetin e shpenzuar secilin shpenzim do ta paraqesim në formën analitike. Buxheti fillestar për vitin 2017 ka qenë 9,540,837.00€, kur kësaj i shtohet edhe bartja e të hyrave vetjake nga viti i kaluar, në shumë prej 1.6 milionë euro, buxheti arrin në shumën prej 11,231,640.16€. Për periudhën janar - mars 2017 buxheti i shpenzuar është në shumë prej 1,435,536.41€, mjetet financiare të zotuarra janë në shumë prej 1,402,938.16€ dhe saldo e mbetur është në shumë prej 1,877,257.84€. Në vertikale për 'paga e mëditje' janë shpenzuar mjetet financiare në shumë prej 1,102,455.04€, për 'mallra e shërbime' janë shpenzuar 61,883.66€, për 'komunali' janë shpenzuar 29,108.98€, për 'subvencione e transfere' janë shpenzuar 17,042.95€ dhe për 'investime kapitale' janë shpenzuar 225,045.78€. Në këtë tremujor buxheti i komunës në total është shpenzuar 15%.

Nazmi Kelmendi: Tani në shqyrtim e kemi çështjen e 'Aprovimit të Raportit Financiar për buxhetin e shpenzuar në tremujorin e parë', për të cilin Drejtori i Financave dhe Buxhetit i dha sqarimet e tij për pozicione të caktuara në mbledhjet e Komitetit për Politikë e Financa dhe këtu në Kuvendin e Komunës, andaj në emër të anëtarëve të Grupit Parlamentar të LDK-së propozoj që 'Raporti Financiar për buxhetin e shpenzuar janar - mars 2017', të aprovohet.

Ylber Islami: Thuhet se vonesat shkaktohen për shkak të procedurave nga Ministria e Financave, ne e shqyrtojmë tani 'Raportin Financiar për buxhetin e shpenzuar në tremujorin e parë', do të duhej që ne tani ta shqyrtojmë 'Raportin gjashtëmujor të shpenzimeve'! Por është njësoj, si gjashtëmujori, si dymbëdhjetmujori, Raporti Financiar është i pashtjelluar, nuk dihet çka është shpenzuar në kategorinë ekonomike të 'investimeve kapitale', të 'mallrave e shërbimeve', të

‘subvencioneve e transfereve’! Nga Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Mjedisit tani janë duke u mbjellur lulet, vendosja e tyre është për gjynah, ato hidhen si nëpër gaca të prushit, nuk qëndrojnë as një ditë, s’ka rëndësi, a vendosen 20 mijë apo 20 lule, në atë vapë pa ujë edhe elefanti vdes! Mungojnë detajet për shpenzimet e bëra, ne tani jemi në vitin e katërt të mandatit tonë, asnjë sugjerim yni nuk merret parasysh, pas katër viteve janë formuar ‘Komitetet tjera Këshilldhënëse’, ato nuk mblidhen. Me paratë që shpenzohen do të kishim drunj bliri, e jo lule që qëndrojnë vetëm dy ditë! Për politika publike jepen rekomandime nga trupat profesionale dhe jepet llogari për paratë e shpenzuara, ndërsa ne nuk e kemi asnjë raport financiar, për asnjë fushë! Në arsim nuk ka raport për përfundimin e vitit shkollor, këtë më së miri e ka treguar ‘Testi i PISA-s’, indikacionet janë se herën tjetër rezultati do të jetë edhe më keq.

Naser Graiçvci: Unë i kam dy vërejtje substanciale, e para, mungesa e raportit në formën analitike dhe vonesat që u cekën edhe nga Drejtori i Financave e Buxhetit u tha se shpenzimet në formën analitike do të prezantohen në ‘Raportin Financiar për buxhetin e shpenzuar në gjashtëmujorin e parë’ dhe e dyta, mbetjet e mëdha nga viti i kaluar. Aspekti real është mirë dhe ne kemi mirëkuptim për çështjet teknike, por edhe këto shpenzime të prezantuara në këtë Raport Financiar, ju e dini se janë pjesë e Kornizës Afatmesme Buxhetore dhe Strategjisë Zhvillimore të Komunës, ku është krijuar një rregull i gabueshëm, shpenzimet për projekte bëhen ‘ad hoc’ pa analiza paraprake, ato rriten, trashen, informimi i qytetarëve nuk bëhet fare!

Trandolina Duli: Unë edhe në mbledhjen e Komitetit për Politikë e Financa kam dhënë kritikën e mia për vonesën e paraqitjes për shqyrtim të ‘Raportit Financiar për buxhetin e shpenzuar janar - mars 2017’. Ky Raport Financiar është paraqitur në mënyrë joprofesionale, është ‘copy-past’, ka gabime teknike, të cilat arkivohen. Në tabelën e alokimeve janë mbi tre milionë euro, ndërsa për projekte kapitale janë shpenzuar vetëm 225,045.78€, kemi teprica të ‘investimet kapitale’, arsyeja është ‘mosplanifikimi afatmesëm dhe afatgjatë’, kur ne na dorëzohet për shqyrtim ‘Raporti Financiar gjashtëmujor i shpenzimit të buxhetit’, vjen me njëzet pika të rendit të ditës, nuk i bëhet një shqyrtim substancial për shpenzimet e realizuara!

Aida Alimi: Ne na shqetëson fakti se buxheti i shpenzuar paraqitet ‘kopy-past’, ka shumë mbetje të mjeteve financiare, ndërsa nevojat për investime publike, në shëndetësi, nëpër shkolla, janë të mëdha, ne i ngrisim problemet, por ato nuk zgjidhen nga Ekzekutivi i Komunës.

Ali Ismaili: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Si buxhet i shpenzuar ky është një ‘kopy-past’, tani kur duhet të shqyrtohet ‘Raporti Financiar gjashtëmujor për buxhetin e shpenzuar’, ne e shqyrtojmë ‘Raportin Financiar tremujor’ me vonesë, gati tre muaj! Ne kemi dhënë sugjerimet tona, por përmirësime nuk ka, tani vjen edhe ‘Raporti i Punës së Kryetarit të Komunës për gjashtëmujorin e parë të vitit 2017’, aty janë të dhënat për projektet e realizuara kapitale nga secila drejtori e komunës, të përsërituara! Ne ndajmë subvencione në disa drejtori të komunës, ndërsa këtu nuk dihet për çka janë shpenzuar mjetet financiare! Në bujqësi ndahen 300 mijë euro subvencione, të tjera ndahen në shëndetësi, arsim, kulturë e sport, shënimet jepen në vija të trasha! Ne kërkojmë të dijmë kujt i ndahen ‘subvencionet’ kush janë përfituesit, për çka shpenzohen mjetet financiare në ‘mallra e shërbime’, të specifikohen ato! Nga ne kërkohet të votohet ‘Raporti Financiar për buxhetin e shpenzuar në tremujorin e parë të vitit 2017’, për tre vite radhazi Partia e

Drejtësisë e ka votuar buxhetin, në kontekst të arritjes së zhvillimit ekonomik në dobi të qytetarëve, por nuk ka reflektim! Andaj ne nuk mund ta votojmë këtë 'Raport Financiar për buxhetin e shpenzuar janar- mars 2017', pa asnjë ndryshim dhe pa sqarime, për shpenzimet e realizuara nga drejtoritë e komunës.

Pas sqarimeve, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës e qiti në votim 'Propozimin për aprovimin e Raportit Financiar për buxhetin e shpenzuar janar-mars 2017'.

U votua me: pesëmbëdhjetë vota 'për', tetë 'kundër' dhe dy 'abstenime, gjithsej njëzet e pesë (25) anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës, me shumicë të votave, e aprovoi 'Raportin Financiar për buxhetin e shpenzuar janar-mars 2017' dhe mori:

V E N D I M

Për aprovimin e buxhetit të shpenzuar për periudhën janar - mars 2017, në shumë të përgjithshme pre 1,435,536.41€.

Pika e katërt (4) - Propozim për shqyrtimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore 2018-2020.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim 'Kornizën Afatmesme Buxhetore Komunale 2018-2020', ftoj Drejtorin e Financave dhe Buxhetit që të na jap sqarime.

Drejtori i FB-së: Korniza Afatmesme Buxhetore 2018-2020 është përgatitur duke u mbështetur në Qarkoren Buxhetore numër një të Ministrisë së Financave, Strategjinë Komunale për Zhvillim Ekonomik 2016-2020 dhe prioritetet e drejtorive të komunës. Grandi për administratë është në shumë të mjetëve financiare prej: 3,266,043.00€, për arsim është në shumë prej: 3,190,208.00€ dhe për shëndetësi është në shumë prej: 948,800.00€. të hyrat vetjake këtë vit do të jenë në shumë prej: 2,723,185.00€. Në tabelën buxhetore 4.2 janë të paraqitura projektet kapitale të secilës drejtori të komunës, të cilat mund të ndryshohen gjatë debateve publike deri në muajin shtator, kur aprovohet buxheti i komunës për vitin 2018. Në faqen e fundit i kemi paraparë edhe tre debate publike me qytetarë, më datë: 7 korrik, 28 korrik dhe 25 gusht dhe një debat tjetër, që çdo herë e mbajmë, me OSBE-në. Buxheti duhet të miratohet nga Kuvendi i Komunës në muajin shtator dhe të dorëzohet në Ministrinë e Financave.

Nazmi Kelmendi: Korniza Afatmesme Buxhetore 2018-2020 është përgatitur në bazë të Qarkores Buxhetore të Ministrisë së Financave, konform së cilës janë caktuar prioritetet dhe projeksionet e buxhetit për vitin e ardhshëm. Ne mund t'i japim sugjerimet tona për ndryshime brenda kufijve të buxhetit nëpër dëgjimet buxhetore, ku prezenca jonë është minimale, në qoftë se ne nuk e japim kontributin tonë dhe propozimet konkrete për ndryshime, këto projekte kapitale mbesin. Është shumë mirë që vitin e ardhshëm në buxhet pritet të rritet numri i punëtorëve të rinj për gjashtëmbëdhjetë. Në emër të anëtarëve të Grupit Parlamentar të LDK-së propozoj që 'Korniza Afatmesme Buxhetore 2018-2020', të aprovohet.

Trandolina Duli: Përsëri edhe Korniza Afatmesme Buxhetore 2018-2020 është një 'kopy-past' pa asnjë ndryshim, përsëriten zërat e njëjtë, pa ide, është viti i tretë pa ndonjë projekt madhor! Komuna jonë për katër vjet nuk ka asgjë konkrete, mund të shikohet vetëm Komuna e Prishtinës,

që është afër dhe reforma e saj në shëndetësi, që është model për gjithë Republikën e Kosovës. Në faqen shtatë thuhet se: 'për të gjitha projektet kapitale drejtoritë e komunës do ta bëjnë përgatitjen e pipave, sepse propozimet pa pipa nuk aprovohen', andaj si t'i votojmë ne projektet kapitale pa asnjë analizë të projekteve!? Drejtori i Financave dhe Buxhetit, në mbledhjen e Komitetit për Politikë e Financa, ka thënë se pipat do të përgatiten në versionin përfundimtar të buxhetit, ne e kemi p.sh.: 'asfaltimet në Fushë-Kosovë 250,000.00€', nuk dihen cilat rrugë do të asfaltohen, nuk ka emra të rrugëve! Unë pyes, pse nuk është shuma 247,000.00€, por shuma fikse 250,000.00€? Kjo është kritika jonë, nuk ka planifikim afatmesëm dhe afatgjatë për zhvillimin e komunës!

Ylber Islami: Në projeksionet buxhetore parashihen të ndërtohen salla të sportit për xhudo, kjo është joserioze, ndërsa në Nakarad ndërtimi i AMF-së, objekt ambulator, në fshatin Sllatinë e Madhe janë të gjitha, për Nakradën prapë në buxhet mungojnë projektet kapitale! Këtij pushteti të çoroditur pas njëzet viteve do t'i bëhet një studim, anashkalohet në tërësi një vendbanim nga projektet publike, bëhen projekte kapitale vend e pavend, ndahen mjete financiare për shpenzime të varrimit, në Nakarad nuk ka as 'Dhomë të Pritjes', sikur në vendbanimet tjera! Kemi investime për ndërtimin e sallave të sportit, mirëmbajtjen e sallave të sportit, këto janë projeksione qesharake për një buxhet! Fusha e ndriçimit publik e Kryetarit të Komunës ka dështuar, tani dritat solare do të kthehen në ndriçimin publik të Korporatës Energjetike të Kosovës! Shpirti të dhemb nga investimet publike të pushtetit, thuaj se ne jetojmë në Zvicër, por duhet të punohet e jo të bëhen improvizime të projekteve jofunksionale! Prona për shkollën e Nakaradës është blerë, është përkthyer në kadastër, ndërtimi i shkollës nuk planifikohet me buxhet, por lejohet operimi i një operatori ekonomik që ndot ambientin, krijohen deponi të egra!

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Korniza Afatmesme Buxhetore 2018-2020 do të aprovohet në parim, propozimet për projekte kapitale mund të jepen në dëgjimet buxhetore.

Naser Graiçevci: Korniza Afatmesme Buxhetore 2018-2020 pajtohem se duhet të aprovohet në parim për debate publike. Ekzekutivi i Komunës e ka propozuar këtë buxhet dhe nuk lejon ndërime sikur edhe vitin e kaluar, kjo shpërfaq politikën e njëjtë, të projekteve kapitale, pa analizë 'ad hoc', p.sh.: 70,000.00€ në bujqësi jepen për serra, ato shpërndahen pa analizë të rezultateve, këto janë vërejtjet tona, kjo është 'Strategjia e zhvillimit ekonomik' të gabuar, pa ndonjë drejtim, sepse kështu mendon Ekzekutivi i Komunës!

Remzi Shala: Unë jam që të aprovohet kjo 'Kornizë Afatmesme Buxhetore 2018-2020', AMF-të janë ambulanca të vogla, por unë dua të sqaroj se ne jemi që shërbimet shëndetësore të ofrohen 24 orë në qendër në Fushë-Kosovë dhe 12 orë në disa vendbanime kryesore, në fshatrat Sllatinë e Madhe dhe Bardh i Madh. Jam kundër ndërtimit të AMF-së në Nakarad, sepse këto ambulanca do të jenë jofunksionale, në fshatin Henc ambulanca është mbyllur. Me ligj nuk lejohet hapja e Qendrave të Mjekësisë Familjare aty ku nuk janë 2500 banorë, sepse edhe numri i pacientëve do të jetë i vogël.

Fazile Sejdiu: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Për shumë arsye ne kemi kërkuar që të bëhet regjistrimi i popullsisë rezidente në Komunën e Fushë-Kosovës. Duhet ta kemi një balancim të shërbimeve shëndetësore në qytet dhe fshatra të Komunës së Fushë-Kosovës. E njëjta vlen edhe për arsimin, ku në qytet kemi shumë nxënës në një klasë, jashtë normave standarde, ndërsa në

fshatra kemi zvogëlim të numrit të nxënësve. Po ashtu, për shkak të migrimit të popullsisë nga të gjitha viset e Kosovës, në qytetin tonë kemi rritje të numri të banorëve. Një vend me 500 banorë mund t'i ketë vetëm pesë pacientë në javë. Pajtohem se Qendra Kryesore Shëndetësore e qytetit duhet të punojë 24 orë, ndërsa Qendrat e Mjekësisë Familjare 12 orë, Ambulancat e Mjekësisë Familjare vetëm gjashtë orë. Shërbimet shëndetësore nuk mund të mbulohen pa mjekë dhe personel mjekësor, duhet ta kemi një planifikim të mirë dhe të balancuar, kjo është domosdoshmëri e kohës për qytetin tonë, ku fluksi i pacientëve viteve të fundit është i madh dhe në rritje të vazhdueshme.

Ali Ismaili: 'Korniza Afatmesme Buxhetore 2018-2020' përbëhet nga disa tabela, p.sh.: në tabelën numër tre paraqiten të hyrat komunale dhe planifikimi për grumbullimin e tyre, në fund është tabela e projekteve kapitale. Në shëndetësi këtë vit do t'i kemi 70,000.00€ për subvencione, ne në të kaluarën vetëm për dy raste i kemi ndarë nga 7,000.00€! Njëjtë është edhe në arsim, ndahen subvencione edhe për studentët në fakultete private, kjo nuk është në rregull! Unë i kam shikuar edhe buxhetet e komunave tjera, edhe Komuna e Prishtinës e paraqet buxhetin e saj në vija të trasha, pa sqarime adekuate. Në buxhetin tonë theksohet 'ndërtimi i fushave sportive' - në shumës, nuk dihet cilat fusha, në cilat fshatra, nuk e kuptoj, pastaj mirëmbajtja e fushave sportive, e tjera! Blerja e inventarit në arsim, nuk është e qartë cilat shkolla kanë nevojë për inventarë, kjo nuk është e sqaruar! Në mbledhjen e Komitetit për Politikë e Financa janë përmendur nga anëtari z. Naser Graiçevci formularët PCF2, PCF3, e tjera, pastaj nga anëtarja znj. Trandolina Duli, shuma prej 250,000.00€ për asfaltim në Fushë-Kosovë, nuk dihet cilat rrugë do të asfaltohen! E kemi kërkesën e qytetarëve për ndërtimin e shkollës në Nakarad, ndërsa nuk parashihet asnjë shumë në buxhet! Në anën tjetër në vitin e kaluar kemi mbetje prej 1.6 milionë euro, të cilat barten për shpenzim në vitin zgjedhor, për realizimin e premtimeve elektorale!

Drejtori i FB-së: Buxheti përgatitet në dokumente standarde në PCF 2, PCF 3 e PCF 4 përgatitet buxheti për 'paga e mëditje', 'mallra e shërbime', 'komunali' dhe 'subvencione e transfere', ndërsa për 'projekte kapitale' përgatiten pipat për secilin projekt veç e veç, brenda kufijve të buxhetit sipas tabelës 4.2, të gjithë pipat për projekte kapitale dorëzohen në Ministrinë e Financave. Buxheti final harmonizohet me mjetet financiare të lejuara me Qarkoren Buxhetore numër dy të Ministrisë së Financave, ku caktohen kufijtë për buxhetin e vitit 2018.

Pas sqarimeve, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës e qiti në votim 'Propozimin për aprovimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore Komunale 2018-2020'.

U votua me: njëzet e dy vota 'për', dy 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej njëzet e katër (24) anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës, me shumicë të votave, e aprovoi 'Kornizën Afatmesme Buxhetore 2018-2020', dhe mori:

V E N D I M

1. Për aprovimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore Komunale 2018-2020, me kufijtë e caktuar buxhetor si vijon:
 - 1.1 Për vitin 2018 buxheti i komunës është në shumë prej: 10,128,236.00€;
 - 1.2 Për vitin 2019 buxheti i komunës është në shumë prej: 10,783,445.00€;

1.3 Për vitin 2020 buxheti i komunës është në shumë prej: 11,654,534.00€.

Pika e pestë (5) - Propozim për konfirmimin e vlefshmërisë së Rregullores për Tatimin në Pronën e Paluajtshme për vitin 2018.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim 'Propozimin për konfirmimin e vlefshmërisë së zbatimit të Rregullores për Tatimin në Pronën e Paluajtshme për vitin 2018', pa ndryshime. Hap diskutimin.

Ylber Islami: Prapë vjen 'Propozimi për konfirmimin e vlefshmërisë së Rregullores për Tatimin në Pronën e Paluajtshme për vitin 2018', pa ndryshime, ku Nakarada mbetet në zonën e dytë tatimore, njësoj me fshatrat tjerë - Vragoli dhe Sllatinë e Madhe që kanë dalje në autostradë, fshatrat tjera janë në zonën e katërt, ndërsa për Nakaradën, kur janë në pyetje tatimet, vendoset në zonën më të lartë tatimore, pyes pse ndodh kjo? Pse ndryshimet që kërkohen me vite nuk lejohet të ndodhin?

Nazmi Kelmendi: Konfirmimi i vlefshmërisë së zbatimit të 'Rregullores për Tatimin në Pronën e Paluajtshme', kërkohet me rregullat dhe Udhëzimet Administrative të Ministrisë së Financave, në kuadër të normave ligjore, andaj në emër të anëtarëve të Grupit Parlamentar të LDK-së propozojmë që kjo Rregullore të miratohet dhe të zbatohet në vitin 2018, pa ndryshime.

Pasi që diskutime tjera nuk pati, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës e qiti në votim 'Propozimin për konfirmimin e vlefshmërisë së zbatimit të Rregullores për Tatimin në Pronën e Paluajtshme për vitin 2018', pa ndryshime.

U votua me: tetëmbëdhjetë vota 'për', një 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej nëntëmbëdhjetë (19) anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës, me shumicë të votave, miraton:

Për zbatim në vitin 2018 pa ndryshime, Rregulloren për Tatimin në Pronën e Paluajtshme.

Pika e gjashtë (6) - Propozim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Palestrës Sportive.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim 'Propozimin për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Palestrës Sportive'. Në qytetin e Fushë-Kosovës Ekzekutivi i Komunës nuk ka mundur të gjejë pronë, andaj ka mbetur mundësia që kjo Palestër e Sporteve, për sportistët e Komunës së Fushë-Kosovës, të ndërtohet në fshatin Miradi e Poshtme për shkak të infrastrukturës që ekziston. Komuna ka pronë edhe në fshatin Lismir, por atje është pjesë më e mbyllur. Hap diskutimin.

Nazmi Kelmendi: Ne jemi të njoftuar me Marrëveshjen e Mirëkuptimit me Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Janë në pyetje mjete të konsiderueshme financiare, në shumë prej 1.5 milionë euro, kjo do të jetë një Palestër e Sporteve për të gjitha klubet tona sportive. Varianti i parë ka qenë sigurimi i pronës në qytet, mirëpo meqë nuk kemi pronë në qytet e kemi zgjedhur variantin e dytë në fshatin Miradi e Poshtme. Një sallë më e vogël sportive për 'Arte Marziale' për ushtrime, që e bënë barazpeshën, do të ndërtohet në Fushë-Kosovë. Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së e

përkrahim 'Propozimin që lokacioni për ndërtimin e Palestrës Sportive' të jetë në fshatin Miradi e Poshtme.

Aida Alimi: Ne e kuptojmë se këto mjete financiare janë donacion, por Grupi Parlamentar i PDK-së mendon se ende nuk janë shterrur të gjitha mundësitë për gjetjen e lokacionit për ndërtimin e Palestrës së Sporteve në Fushë-Kosovë, njëri nga opsionet është vendi te tregu.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Nuk ka mundësi që Palestra e Sporteve të ndërtohet në lokacionin te tregu, sepse hapësira është e vogël, mirëpo ky është opinioni juaj.

Ylber Islami: Fillon mbledhja me pesëmbëdhjetë pika të rendit të ditës, pa kurrfarë qëllimi dhe analize për reduktimin e shpenzimeve! Propozohen për ndërtim Palestra të Sporteve në fshatrat Miradi e Poshtme, Miradi e Epërme, vijnë propozime nga një takim me Majlinda Kelmendin! Rezultatet e saj si sportiste ne i vlerësojmë, por ne e kemi vetëm një vizatim me ngjyrë të zezë, po ashtu ne mendojmë se as vendlindja e saj në Pejë nuk i japin një përkrahje të tillë! Propozimi është i papërgatitur dhe joserioz!

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Dua të sqaroj se kjo është një sallë e vogël për 'Arte Marciale' e cila do të jetë për përgatitjen e sportistëve për sporte luftarake dhe gjimnastikë, lokacionin e cakton Ekzekutivi i Komunës, aty ku ka mundësi.

Ylber Islami: Këto propozime po kalkulohe me vota elektorale, pa u pyetur fare qytetarët, nuk dihet a do të ketë ndonjë ankesë, apo padi në gjyq, shkohet menjëherë në periferi, pa asnjë arsytim logjik! Ky pushtet është lodhur për njëzet vjet në qeverisje, është konsumuar. Këtu afër komunës janë tridhjetë ari tokë, Palestra e Sporteve duhet të ndërtohet në qytet.

Naser Graiçevci: Mjetet financiare janë nga granditë e qeverisë, por nuk është konsumuar ende gjithçka! Mendojmë se Palestra e Sporteve ndërtohet për qytetarët, aty ku fluksi i njerëzve është më i madh, andaj Grupi Parlamentar i PDK-së është që Palestra e Sporteve të ndërtohet brenda qytetit, sepse kjo është e rëndësishme për sportistët dhe qytetarët për zhvillimin e aktiviteteve sportive.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Kjo Palestër e Sporteve do të ndërtohet për sportistët e Fushë-Kosovës, nevojitet një ngastër kadastrale më e madhe, në qytet nuk ka pronë.

Naser Graiçevci: Meqë kjo do të jetë një palestër e veçantë dhe po vendoset në periferi, pa u analizuar mirë të gjitha mundësitë, ne do të abstenojmë.

Ali Ismaili: Ne e falënderojmë Ministrinë e Kulturës, Rinisë e Sportit dhe Ekzekutivin e Komunës për sigurimin e këtij granditë për ndërtimin e Palestrës së Sporteve në qytetin tonë. Në mbledhjen e Komitetit për Politikë e Financa kemi kërkuar që Ekzekutivi i Komunës të vjen me propozime konkrete, prona ka vetëm në fshatrat: Miradi e Poshtme dhe Lismir. Mendoj se ne duhet ta kemi një vizion për zhvillimin e sportit për periudhën afatgjatë, andaj lokacioni në fshatin Miradi e Poshtme nuk është larg, rruga është autostradë dhe shkuarja e sportistëve dhe klubeve tona atje, nuk paraqet ndonjë problem të madh. Në qytet ne nuk i kemi as Hartat Zonale që parashihen me ligj, nuk po kemi hapësirë të mjaftueshme, as për shkollë apo ambulancë! Në qytetin e Fushë-Kosovës duhet t'i kemi së paku dhjetë ngastra kadastrale për ndërtimin e objekteve fetare - xhamisë, kishës, shkollës, objektit për të moshuar, stadiumet dhe objektet sportive zakonisht bëhen

në periferi, në Fushë-Kosovë nuk i kemi askund tridhjetë ari tokë. Ky investim publik mendoj se është i qëlluar për sportistët e Komunës së Fushë-Kosovës.

Pas sqarimeve, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës e qiti në votim 'Propozimin për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Palestrës së Sporteve në Ngastrën Kadastrale numër 196, në fshatin Miradi e Poshtme'.

U votua me: gjashtëmbëdhjetë vota 'për' asnjë 'kundër' dhe gjashtë abstenime, gjithsej njëzet e dy (22) anëtarë të prnishëm.

Në bazë të votimit, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës, me shumicë të votave, e aprovoi 'Propozimin për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Palestrës së Sporteve në Ngastrën Kadastrale Nr. 196, në fshatin Miradi e Poshtme' dhe mori:

V E N D I M

Për aprovimin e Propozimit Nr. 465, të datës 16.05.2017 për: 'Caktimin e lokacionit për ndërtimin e Palestrës së Sporteve në Ngastrën Kadastrale Nr. P-72514027-00196-1, e evidentuar në certifikatën e pronës Nr. 25-7129 dhe Ngastrën Kadastrale Nr. P-72514027-00196-2, e evidentuar në certifikatën e pronës Nr. 25-7130, në vendin e quajtur 'Livade-Pashnjak', në fshatin Miradi e Poshtme'.

Pika e shtatë (7) - Propozim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Sallës së Sporteve për 'Arte Marciale'.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim 'Propozimin për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Sallës së Sporteve për 'Arte Marciale' në Fushë-Kosovë'. Kjo sallë, për ushtrimet e sportistëve të sporteve luftarake nga komuna jonë, do të ndërtohet në hapësirën ndërmjet çerdhes dhe sallës së sportit. Hap diskutimin.

Ylber Islami: Kjo është një kontradiktë, tani propozohet të caktohet lokacioni për ndërtimin e Sallës së Sporteve për 'Arte Marciale', askund nuk figuron ngastra kadastrale në propozimin e dhënë, ndërsa propozohet të lejohet shuma e mjeteve financiare në shumë prej 340,000.00€, ky propozim është joserioz! Nuk ka asnjë specifikë teknike se si do të ndërtohet kjo sallë te çerdhja e fëmijëve.

Nazmi Kelmendi: Mendoj se duhet të precizohet me saktësi ngastra kadastrale në cilën do të ndërtohet Salla e Sporteve për 'Arte Marciale' në Fushë-Kosovë. Kjo sallë do të jetë në një hapësirë prej 350m² dhe do të jetë funksionale për zhvillimin e ushtrimeve dhe përgatitjes për gara sportive të sportistëve të klubeve tona të sporteve luftarake. Ndërtimi duhet të bëhet në përputhje me kushtet urbanistike, andaj në emër të anëtarëve të Grupit Parlamentar të LDK-së propozoj që të caktohet lokacioni për ndërtimin e Sallës së Sporteve për 'Arte Marciale' në Fushë-Kosovë, në hapësirën ndërmjet çerdhes së fëmijëve dhe sallës së sportit.

Ali Ismaili: Përpilimi i kësaj kërkesë nuk është në rregull, thuhet se kjo ka rrjedhur nga një takim i sportistes, znj. Majlinda Kelmendi, në Fushë-Kosovë! Propozohet që të ndërtohet një Sallë e Sporteve që kushton 340,000.00€, nuk ka asnjë arsyetim, kjo ka ndodhur nga një takim privat! Ne nuk jemi në dijeni sa klube të sporteve luftarake i kemi, sa është numri i sportistëve tanë, në cilën ligë garojnë ata, në të parën, apo në të katërtën! Theksohet se sipërfaqja e saj duhet të jetë pesë deri në dhjetë ari.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Sqaroj se kjo Sallë e Sporteve për 'Arte Marciale' do të ndërtohet për klubet dhe sportistët e komunës tonë, nuk ka të bëjë me sportisten znj. Majlinda Kelmendi.

Ali Ismaili: Pyes, a ka patur takime me klubet e Fushë-Kosovës, këto fakte unë po i lexoj në propozimin e Ekzekutivit të Komunës? Sportistja, znj. Majlinda Kelmendi është krenaria jonë, ka arritur ta merr Medaljen e Artë në Olimpiadë dhe kjo është për ta vlerësuar. Problemi qëndron në atë se ne nuk kemi hapësirë për nxënës aty, e po ndërtojmë Sallë të Sporteve në oborrin e shkollës, kjo nuk është fare në rregull!

Naser Graiçevci: Ky propozim është jashtë normave të lejuara për ta shqyrtuar Kuvendi i Komunës! Kjo është një ide e paartikulluar, mungon projekti, ndërsa thuhet se do të ndahen 340,000.00€! Ne e dimë se Klubet e Boksit dhe të Karatesë nga komuna jonë kanë rezultate në sport dhe duhet të përkrahen. Hapësira në zonën e shkollës aty është e rënduar edhe për sy dhe jashtë rregullave urbanistike. Ndërtohen objekte jofunksionale, pa plan, pastaj brengë në vete është edhe mirëmbajtja e tyre, e cila ka kosto financiare, pse është kjo nguti! E vetmja arsye është se kemi të bëjmë me një projekt politik të radhës, i cili duhet të aprovohet, të caktohet lokacioni, ndërsa ne nuk kemi propozim të detajuar nga Ekzekutivi i Komunës!

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Ne sot do të vendosim për lokacionin, jo për mjetet financiare. Kjo sallë do të ndërtohet në hapësirën ndërmjet çerdhes së fëmijëve dhe sallës së sportit, do të jetë në funksion të sportistëve të komunës tonë për ushtrime dhe përgatitje për gara sportive.

Pas sqarimeve, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës e qiti në votim 'Propozimin për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Sallës së Sporteve për 'Arte Marciale' në Fushë-Kosovë'.

U votua me: trembëdhjetë vota 'për' tetë 'kundër' dhe një abstenim, gjithsej njëzet e dy (22) anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës, me shumicë të votave, e aprovoi 'Propozimin për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Sallës së Sporteve për Arte Marciale, në Fushë-Kosovë' dhe mori:

V E N D I M

Për aprovimin e Propozimit Nr. 555, të datës 15.05.2017 për: 'Caktimin e lokacionit për ndërtimin e Sallës së Sporteve për 'Arte Marciale' në Ngastrën Kadastrale Nr. P-72514036-00792-1, e evidentuar në certifikatën e pronës Nr. 25-7233, në vendin e quajtur 'Selo Igralishte', në Fushë-Kosovë'.

Pika e tetë (8) - Propozim për ndërrimin e destinimit të pronës për ndërtimin e 'Qendrës rekreativo-sportive' në fshatin Miradi e Epërme.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim 'Propozimin për ndërrimin e destinimit të pronës për ndërtimin e 'Qendrës rekreativo-sportive' në fshatin Miradi e Epërme'. Hap diskutimin.

Nazmi Kelmendi: Këtu kemi të bëjmë me një 'Propozim për ndërrimin e destinimit të pronës për ndërtimin e 'Qendrës rekreativo-sportive' në fshatin Miradi e Epërme', por lidhur me ndërtimin e këtij kompleksi sportiv duhet ta marrim mendimin e banorëve të zonës.

Ylber Islami: Tani e kemi 'Propozimin për ndërrimin e destinimit për ndërtimin e Qendrës rekreativo-sportive', por nuk e kemi marrë mendimin e qytetarëve të fshatit Miradi e Epërme. Pyes, pse kjo Qendër e Sportit duhet të ndërtohet atje, kur me plan ajo zonë është për zhvillimin e industrisë, apo del një person, Bujar Avdullahu, dhe ne duhet ta bëjmë ndërrimin e destinimit në funksion të zhvillimit të biznesit privat, pa e ndërruar Planin Zhvillimor Komunal'.

Drejtori i PU-së: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Këtu kemi të bëjmë me kërkesën e një biznesi privat, aty do të ndërtohet një Qendër Sportive, me karakter komercial. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka kërkuar që ne ta bëjmë ndërrimin e planeve komunale në bazë të ligjit në fuqi.

Aida Alimi: Ne jemi që zhvillimit të biznesit privat t'i japim mundësinë për operimin e tij, por duke i respektuar rregullat e parapara me ligj.

Pas sqarimeve, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës e qiti në votim 'Propozimin për ndërrimin e destinimit të pronës për ndërtimin e 'Qendrës rekreativo-sportive' në fshatin Miradi e Epërme'.

U votua me: nëntëmbëdhjetë vota 'për' asnjë 'kundër' dhe dy abstenime, gjithsej njëzet e një (21) anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës, me shumicë të votave, e aprovoi 'Propozimin për ndërrimin e destinimit të pronës për ndërtimin e 'Qendrës rekreativo-sportive' në fshatin Miradi e Epërme' dhe mori:

V E N D I M

Për aprovimin e Propozimit Nr. 253, të datës 14.06.2017 për: 'Ndërrimin e destinimit të pronës nga ndërtimi i objekteve industriale në 'Qendër Rekreative-Sportive' si vijon: stadium të madh - faza e parë, stadium të vogël - faza e dytë dhe objekt afarist me etazhitet P+2 - faza e tretë, në Ngastrën Kadastrale Nr. P-72514014-00126-1, e evidentuar në certifikatën e pronës Nr. 14-464-8345, në sipërfaqe prej 9000m², në vendin e quajtur 'Veternik' dhe në Ngastrën Kadastrale Nr. P-72514014-00126-3, e evidentuar në certifikatën e pronës Nr. 14-464-8350, në sipërfaqe prej 3358m², në vendin e quajtur 'Veternik' në fshatin Miradi e Epërme'.

Pika e nëntë (9) - Shqyrtimi i parë i Projekt-Planit Zhvillimor të Arsimit 2017-2019.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi në shqyrtimin e parë 'Projekt-Planin Zhvillimor të Arsimit 2017-2019', ftoj Drejtorin e Arsimit që të na jap sqarime.

Drejtori i Arsimit: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. 'Projekt-Plani për Zhvillimin e Arsimit në shkollat e Komunës së Fushë-Kosovës 2017-2019' është punuar nga drejtorët e shkollave duke i përfshirë prioritetet e tyre për investime publike në arsim. Në hartimin e këtij plani kemi bashkëpunuar me GIZ-in gjerman. Ky plan trevjeçar është hartuar duke u mbështetur në 'Planin Strategjik Kombëtar për Zhvillimin e Arsimit'. Janë caktuar pesë prioritete për tre vitet e ardhshme, duke u bazuar në nevojat e shkollave tona: 'pajisjen e shkollave me kabinete', 'përmirësimin e cilësisë në mësim', 'gjithëpërfshirjen e komuniteteve' dhe 'eliminimin e dukurisë së braktisjes', që është prezente te komunitetet: rom, ashkalinj dhe egjiptas.

Nazmi Kelmendi: Në këtë 'Projekt-Plan për Zhvillimin e Arsimit 2017-2019' janë paraqitur nevojat reale të shkollave, duke i caktuar prioritetet për investime publike në periudhën trevjeçare. Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së pajtohem që 'Projekt-Plani për Zhvillimin e Arsimit

2017-2019' të aprovohet në parim dhe të kalojë në diskutim publik, para miratimit përfundimtar të tij në Kuvendin e Komunës.

Ylber Islami: Fusha e arsimit është një shqetësim për të gjithë, mungojnë raportet për përfundimin e vitit shkollor. Problemet janë paraqitur edhe në media, në Komunën e Fushë-Kosovës Sociologu e jep lëndën e matematikës, andaj rezultatet i tregon edhe vetë 'Testi i PISA-s'! Për këto fakte do të duhej të jenë të shqetësuar Drejtoria Komunale e Arsimit, drejtorët e shkollave, nuk funksionon segmenti prind - mësimdhënës, po krijohen analfabetë funksional në shkollat tona, ky është halli. Në Shkollën 'Selman Riza', kemi informata se një mësimdhënës zhvillon dhunë ndaj nxënësve, ata rrahen me rryp, ndërsa ju prapë nuk i pranoni këto fakte, duhet të formohet një Komision për verifikimin e rasteve të tilla, mësimdhënësit kanë emër, ju e dini cili është. Ju hartoni plane tre-vjeçare, shumëvjeçare, asnjë përmirësim substancial nuk bëhet! Janë themeluar Komitetet tjera Këshilldhënëse, ato nuk mblidhen, problemet ekzistuese nuk shqyrtohen, nxënësit nëpër klasa të qytetit e kalojnë dyfishin e normave të lejuara me standarde, ndërsa në fshatra mbyllen shkollat, siç është rasti i fshatit Bardh i Vogël. Mësimi në shkollat tona po bëhet si gjatë luftës, si në Kampin e Stankovecit, pa kushte për mësim cilësor.

Drejtori i Arsimit: Ju po shihni gjithçka zi dhe po flisni në mënyrë 'paushalle'. Shkollat janë të pajisura me kompjuterë e laptopë, vetëm Gjinnazi i ka 100 kompjuterë, kaq kompjuterë nuk i kanë në total komunat tjera. Në shkollat tona këtë vit nuk kemi patur asnjë rrahje, asnjë plagosje, raste të tilla ka patur në komunat tjera të Kosovës. Në komunën tonë kemi migrim të popullsisë nga të gjitha viset shqiptare, por nuk kemi probleme që vlejnë të theksohen nëpër shkollat tona, edhe pse nxënësit janë duke ardhur nga mjedise të ndryshme. Vetëm para katër viteve ka patur një suspendim të një mësimdhënësi, por jo vjet, jo sivjet, nuk qëndron fakti se Sociologu jep matematikë, të gjithë arsimtarët e matematikës janë me kualifikim 'bachelor' dhe 'master'. Mësimdhënës të caktuar kanë dhënë mësim në të kaluarën nxënësve që e kanë braktisur mësimin nga radhët e komuniteteve, ka patur mësim plotësues në lëndët: Edukatë Qytetare dhe Gjuhë Shqipe, por ky rast nuk është precizuar drejt, asnjë mësimdhënës me kualifikimin e sociologjisë, nuk jep matematikë në Fushë-Kosovë, kjo nuk është e saktë.

Ylber Islami: Unë këtu nuk kam asgjë personale. Pas luftës, viteve të fundit, ka ndodhur punësim familjar në arsim, ju këtë e dini më së miri që ka nepotizëm. Sa mësimdhënës janë punësuar prej Kryetarit të Komunës dhe prej jush? Janë mbi shtatë anëtarë nga një familje! Nuk respektohen kriteret profesionale dhe konkursi. Subvencionet që ndahen në arsim nuk janë publike. Unë nuk po e them këtë fakt, e ka thënë Auditori i Jashtëm.

Naser Graiçevci: Planifikimi për arsimin për periudhën e ardhshme trevjeçare është i shkruar mirë dhe paraqet pika të ndritshme, nëse zbatohet për zhvillimin e arsimit. Megjithatë, brenda materialit janë edhe disa çështje pak a shumë konfuze. Ne kemi problem me njerëzit e rinj që vijnë të banojnë në Fushë-Kosovë, duhet ta respektojmë ligjin dhe të bëjmë regjistrimin e tyre, sepse vetëm kështu do të rritet grandia qeveritar për arsimin. Ngritja e cilësisë në arsim, për këtë segment nuk parashihet asnjë shumë e mjeteve financiare, thuhet se trajnimet do të zhvillohen nga Ministria e Arsimit dhe GIZ-i gjerman, unë mendoj se edhe ne duhet të ndajmë mjete financiare për rritjen e cilësisë në mësimdhënie. Në fushën e arsimit ne kemi probleme diametralisht të kundërta, në Fushë-Kosovë

i kemi mbi 45 nxënës nëpër klasa, ndërsa në fshatin Bardh i Vogël është mbyllur shkolla. Numri i vogël i nxënësve është edhe në disa fshatra tjerë, andaj duhet ta kemi një plan të veprimit për ndryshimin e gjendjes ekzistuese. Disiplina nëpër shkolla duhet të rritet, të mos përdoret dhuna, por të gjenden forma të arsyeshme për një cilësi në mësim dhe menaxhim të situatës, unë mendoj se liria e nxënësve tani është një çështje për debat të mirëfilltë nga përgjegjësit e sistemit arsimor. Shkollat duhet ta kenë edhe autonominë e tyre financiare, problemi është se ato po menaxhohen nga Drejtoria e Arsimit. Edukimi parashkollor në Fushë-Kosovë nuk funksionon, duhet të punohet në këtë drejtim, këto janë vërejtjet tona. Ne jemi që të aprovohet në parim për diskutim publik 'Projekt-Plani Komunal për Zhvillimin e Arsimit 2017-2019'.

Pas sqarimeve, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës e qiti në votim për aprovim në parim për diskutim publik 'Projekt-Planin Komunal për Zhvillimin e Arsimit 2017-2019'.

U votua me: njëzet vota 'për' asnjë 'kundër' dhe dy abstenime, gjithsej njëzet e dy (22) anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës, me shumicë të votave, e aprovoi në parim për diskutim publik 'Projekt-Planin Komunal për Zhvillimin e Arsimit 2017-2019' dhe mori:

V E N D I M

Për aprovimin në parim të 'Projekt-Planit për zhvillimin e arsimit në Komunën e Fushë-Kosovë 2017-2019' dhe procedimin e tij për diskutim publik.

Pika e dhjetë (10) - Shqyrtimi i kërkesës së Shoqatës 'Trojet tona' për lejimin e dhënies në shfrytëzim të një zyreje në objektin e Shtëpisë së Kulturës në Fushë-Kosovë.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim 'Kërkesën e Shoqatës 'Trojet tona' për lejimin e dhënies në shfrytëzim të një zyreje në objektin e Shtëpisë së Kulturës në Fushë-Kosovë'. Hap diskutimin.

Nazmi Kelmendi: Edhe në mbledhjen e Komitetit për Politikë e Financa kemi debatuar për çështjen e qytetarëve nga Lugina e Preshevës. Ne i mirëkuptojmë kërkesat e tyre, një pjesë e qytetarëve nga ato vise shqiptare jetojnë në qytetin e Fushë-Kosovës që nga viti 1967-1968 e tutje. Pjesa tjetër e të drejtave, siç është sigurimi i shtetësisë, janë kompetencë e nivelit qendror, nuk janë kompetencë e nivelit komunal. Sigurimi i kushteve tjera për veprim do të bëhet në përputhje me mundësitë tona. Për objektin e Shtëpisë së Kulturës është marrë një vendim për rrënimin e objektit ekzistues dhe fillimin e procedurave për ndërtimin e objektit të ri. Ne nuk do të lejojmë që të bëhen ndarje, qytetarët e Fushë-Kosovës janë të barabartë në realizimin e kërkesave të tyre para institucioneve lokale, nuk pranojmë kurrfarë ndarje: Drenicë, Llap, Jerli, Muhaxherë, nga qytetarë nga Gjilani apo Lugina, të gjithë janë të barabartë, andaj ne para vetes e kemi propozimin e Ekzekutivit të Komunës për realizimin e një të drejte, kërkesës për dhënie në shfrytëzim të një zyreje për Shoqatën 'Trojet tona', në objektin e Shtëpisë së Kulturës dhe propozimin në fjalë e përkrahim për aprovim.

Trandolina Duli: Punën e ndarjes e bëtë ju, tani, qytetarë të Fushë-Kosovës janë njësoj edhe qytetarët nga fshatrat: Miradi e Poshtme, Sllatina e Madhe, ne nuk bëjmë kurrfarë ndarje. Qytetarët e Medvegjes që jetojnë në Fushë-Kosovë, përmes Shoqatës së tyre 'Trojet tona', kanë parashtruar

një kërkesë për: 'Lejimin e dhënies në shfrytëzim të një zyreje në objektin e Shtëpisë së Kulturës për realizimin e aktiviteteve të tyre'.

Nazmi Kelmendi: Unë jam shumë korrekt në diskutimin tim, të gjithë qytetarët e Fushë-Kosovës duhet të kenë trajtim të barabartë, këtë çështje e kam theksuar edhe në mbledhjen e Komitetit për Politikë e Financa.

Drejtores e Administratës: Qytetarët e Luginës që nga viti 1999 një pjesë e tyre janë zhvendosur në Kosovë, shumica në Komunën e Gjilanit, Kamenicës dhe Fushë-Kosovës, ata kanë problemet e veta lidhur me rregullimin e dokumentacionit civil, andaj ata kërkojnë një hapësirë që të kenë mundësi të merren me aktivitetet e tyre.

Ylber Islami: Realizimi i kësaj kërkesë po bëhet në llogari të interesave të pushtetit, vetëm tre muaj para zgjedhjeve. Këta qytetarë kanë nevojë të përkrahen gjatë gjithë vitit, nga cilado parti politike, pavarësisht se a është në pozitë apo opozitë. Kush janë përfaqësuesit e kësaj shoqate, cilat interesa i mbrojnë ata? Sepse ne po bëjmë shumë strategji për shumë komunitete, pa analiza të mirëfillta dhe serioze! Ne si parti politike dhe përfaqësues politikë, asnjëri nuk kemi zyrë, edhe pse këtë e lejon ligji. Qytetarët e Luginës së Preshevës janë në gjendje të rëndë dhe këto punë kërkojnë zgjidhje dhe trajtim mes dy shteteve, por edhe nga organet e shtetit të Kosovës, Presidenti i Republikës së Kosovës dhe Qeveria e Kosovës.

Naser Graiçevci: Në rend të parë qytetarët nuk duhet të ndahen, pavarësisht se a kanë prejardhje nga fshati Hade, Komuna e Medvegjes, apo pjesë tjera të Kosovës, ata duhet të ndihen qytetarë të Fushë-Kosovës me mburrje. Andaj, unë pajtohem në këtë kontekst me mendimin e anëtarit të Kuvendit të Komunës z. Nazmi Kelmendi që të mos ketë ndarje, qytetarët që e kanë zgjedhur Fushë-Kosovën për vendbanim të tyre, janë të barabartë. Rregullimi i dokumentacionit është në kompetencën e nivelit qendror, ne jemi që kjo kërkesë të përkrahet, por kjo shoqatë nuk e përfaqëson Luginën e Preshevës, si rajon gjeografik i viseve shqiptare, por është vetëm një Shoqatë 'Trojet tona', që merret me realizimin e aktiviteteve kulturore dhe ruajtjen e traditës së qytetarëve me origjinë nga Komuna e Medvegjes.

Sabri Rexhepi: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Sot ka ardhur një 'Kërkesë për dhënie në shfrytëzim të një zyreje në objektin e Shtëpisë së Kulturës, për qytetarët e Komunës së Medvegjes', të cilët jetojnë në Fushë-Kosovë për njëzet, apo edhe pesëdhjetë vjet, është njësoj. Ata kanë probleme të natyrës së njëjtë, edhe për qytetarët me origjinë nga Presheva dhe Bujanoci, puna e tyre duhet të trajtohet dhe të zgjidhet nga institucionet qendrore dhe lokale të Kosovës.

Ali Ismaili: Kolegë të nderuar, unë mendoj se kjo çështje është 'puro' politike! U tha nga përfaqësuesi i LDK-së se: 'rregullimi i dokumentacionit civil është në kompetencën e nivelit qendror'! Në kërkesën e tyre shkruan: Klubi vendlindja 'Trojet', kjo ndryshon me licencën e dhënë nga organi përgjegjës për veprimin e tyre si Organizatë Joqeveritare. Qytetarët e Preshevës janë vendosur në Fushë-Kosovë para pesëdhjetë viteve dhe kanë probleme dhe halle të mëdha. Unë pyes, a jemi ne duke punuar me ligjet e Kosovës, sepse, ne si subjekte politike, me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale na takon nga një zyrë për punë, që të merremi me trajtimin e interesave të qytetarëve, e nuk e kemi, jemi për katër vite asamblistë?! Në anën tjetër ndajmë me mijëra euro mjete financiare për Organizatat Joqeveritare. Sigurimi i zyrave duhet të bëhet për shumicën e

shoqatave që përfaqësojnë një komunitet të caktuar, e jo të zgjidhen çështjet 'ad hoc', sipas kërkesave! Qytetarët e Komunave: Preshevë, Bujanoc e Medvegjë meritojnë një trajtim serioz, sepse kanë probleme më të theksuara edhe me dokumentacionin civil, andaj ne i përkrahim kërkesat e tyre.

Pas sqarimeve, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës e qiti në votim 'Kërkesën e Shoqatës 'Trojet tona' për lejin e dhënies në shfrytëzim të një zyreje në objektin e Shtëpisë së Kulturës në Fushë-Kosovë'.

U votua me: trembëdhjetë vota 'për' asnjë 'kundër' dhe gjashtë abstenime, gjithsej nëntëmbëdhjetë (19) anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës, me shumicë të votave, e aprovoi 'Kërkesën e Shoqatës 'Trojet tona' për lejin e dhënies në shfrytëzim të një zyreje në objektin e Shtëpisë së Kulturës në Fushë-Kosovë' dhe mori:

V E N D I M

Aprovohet Kërkesa Nr. 01-016-9985, të datës 15.03.2017 për: 'Dhënien në shfrytëzim të një hapësire të nevojshme për zhvillimin e aktiviteteve në funksion të realizimit të kërkesave për rregullimin e dokumentacionit, ruajtjen e vlerave kulturore dhe traditës, ndahet një zyrë për punë në objektin e Shtëpisë së Kulturës në Fushë-Kosovë, rruga 'Nënë Tereza', për Klubin 'Trojet Tona' të shqiptarëve nga Medvegja'.

Pika e njëmbëdhjetë (11) - Propozim për shqyrtimin e kërkesës Nr. 020-744/3, të datës 02.06.2017, për vendimin Nr. 81, të datës 15.05.2017 për lejin e ndërtimit të lartë në Fushë-Kosovë.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim 'Propozimin për ndryshimin e vendimit Nr. 81, të datës 15.05.2017', ftoj Drejtorin e Planifikimit Urban që të na jap sqarime.

Drejtori i PU-së: Lidhur me vendimin e marrë nga Kuvendi i Komunës, muajin e kaluar, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka konstatuar se nuk është bërë në përputhje me dispozitat ligjore, ka kërkuar që të mos ndërrohet destinimi, por të ndryshohet Plani Zhvillimor Urban dhe Plani Rregullues Urban për lejin e ndërtimeve të larta në Fushë-Kosovë, pastaj të hartohen Hartat Zonale. Pika dy e vendimit do të ndryshohet, në përshkrim nuk do të jenë më ngastrat kadastrale, por blloqet e reja të banimit, njësoj do të veprohet edhe me pikën tjetër për ndërtime të larta nga rruga e çerdhes deri te udhëkryqi.

Naser Graiçevci: Tani këtu e kemi një rikthim të vendimit nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor! Duhet të vendoset në zbatim ligji, të mos ketë nevojë të veprojnë as gjykata, as prokuroria, por të mbrohen edhe interesat e banorëve në atë zonë, të cilët i kanë prishur tani shtëpitë e tyre dhe kanë dilema, qytetarët kanë halle. Fajtores është Drejtoria e Planifikimit Urban që ka lejuar së pari ndryshimin të lagjja e 'Merovcëve', duke vepruar në mënyrë individuale! Ai vendim nuk është kërkuar të rishqyrtohet dhe ndërtimi i shtëpive katërkatëshe nga 'British Homes', tani aty kemi ndërtime katërkatëshe dhe tetëkatëshe, në të njëjtën zonë. Kjo punë tani është edhe çështje humanitare dhe duhet të rregullohet për njerëzit.

Drejtori i PU-së: Ne jemi në dijeni për shqetësimet e qytetarëve, por kemi kërkuar që pa lejen tonë ata të mos i prishin shtëpitë e tyre. Në rastin e 'Merovcëve' Ministria e Mjedisit dhe

Planifikimit Hapësinor nuk ka reagu. Hartimi i Hartave Zonale duhet të bëhet në bazë të 'Ligjit për Planifikimin Hapësinor Nr. 04/L-174', por ne tani duhet ta ndërrojmë Planin Zhvillimor Komunal për atë zonë dhe vendimi shkon në Ministrinë e Mjedisit, duhet të shënohet se ndryshohet plani përkatës për zonën e caktuar dhe për njerëzit atje do të rregullohen çështjet, përveç blloqeve të përmendura në propozim, aty është edhe blloku i banimit A8.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Drejtori i Planifikimit Urban e sqaroi procedurën e ndryshimit të vendimit në fjalë në përputhje me dispozitat ligjore.

Ylber Islami: Drejtori i Planifikimit Urban i dha sqarimet konkrete, faji nuk është i qytetarëve, por i Komunës dhe Ministrisë së Mjedisit. Sipas vendimit të muajit mars të vitit të kaluar Kompania e ndërtimit 'Cima Konstraksion' por ndërton në lagjen e 'Merovcëve' dhe ka tejkalim! Unë e kam ngritur këtë problem në Kuvendin e Komunës, tani kemi problem me ndërtimin në lagjen e 'Graçevcëve', pse këtu reagon e atje jo? Komuna në këtë rast është më pak fajtores se Ministria e Mjedisit. Cilat janë obligimet e Ministrisë së Mjedisit në këtë proces të ndërtimeve të larta? Audioincizimet nuk publikohen, andaj nuk dihen problemet për qytetarë, ata i prishin shtëpitë e tyre, Grupi Parlamentar i LDK-së nuk flet asnjë fjalë, njësoj veprojnë edhe 'patericat' tjera.

Ali Ismaili: Unë do t'i them dy fjalë, pasi që jam edhe Këshilltar i Ministrit të Mjedisit atje. Ideja është se niveli qendror vepron në bazë të kërkesave të nivelit lokal dhe konstaton a po zbatohet ligji në bazë të dokumentacionit specifik apo jo. Ministria e Mjedisit ka kërkuar që të mos ndërrohet destinimi por të ndryshohet planifikimi urban. Tani duhet të hartohen Hartat Zonale sipas 'Ligjit për Planifikim Hapësinor', në nivelin qendror dhe lokal. Vetëm Graçanica i ka bërë disa harta, as Podujeva, as Fushë-Kosova, asnjë komunë tjetër, as ne si Ministri e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor nuk i kemi, sepse mungojnë ekspertë të kësaj fushe, tani ka lëvizur diçka, në bashkëpunim me Ambasadën Amerikane, USAID-in, GIZ-in gjerman, por procesi është në fazën fillestare.

Pas sqarimeve, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës e qiti në votim 'Propozimin për ndryshimin e pikës dy të vendimit Nr. 81, të datës 15.05.2017, ndryshimin e Planit Zhvillimor Urban dhe Planit Rregullues Urban për zonën e cekur në propozim lidhur me blloqet e reja të banimit'

U votua me: nëntëmbëdhjetë vota 'për', asnjë 'kundër' dhe një abstenim, gjithsej njëzet (20) anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës, me shumicë të votave, e aprovoi 'Propozimin për ndryshimin e vendimit Nr. 81, të datës 15.05.2017, ndryshimin e Planit Zhvillimor Urban dhe Planit Rregullues Urban për zonën e cekur në propozim lidhur me blloqet e reja të banimit' dhe mori:

V E N D I M

Aprovohet 'Propozimi Nr. 591, i datës 21.06.2017, për ndryshimin e vendimit Nr. 81, të datës 15.05.2017', nga 'ndërrimi i destinimit të shfrytëzueshmërisë së lokacionit', në: 'ndryshimin e Planit Rregullues të Hollësishëm' për blloqet e banimit: A8, A12, A13, A14, E18/1, E19, H2 dhe H3 në Fushë-Kosovë.

Pika e dymbëdhjetë (12) - Propozim për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore, në tokë ndërtimore për subjektin afarist 'Xini Invest' në fshatin Harilaç.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim 'Propozimin për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore, në tokë ndërtimore për subjektin afarist 'Xini Invest' në fshatin Harilaç, ftoj Drejtorin e Planifikimit Urban që të na jap sqarime.

Drejtori i PU-së: Këtu kemi të bëjmë me një sipërfaqe prej 6664m² për depo, prona është private, e klasës së pestë, andaj është kompetencë e Kuvendit të Komunës që të bëjë shndërrimin e tokës bujqësore, në tokë ndërtimore.

Ylber Islami: Pyes, pse investimi i njëjtë nuk bëhet në nakaradë?.

Pas sqarimeve, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës e qiti në votim 'Propozimin për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore, në tokë ndërtimore për subjektin afarist 'Xini Invest' në fshatin Harilaç'.

U votua me: nëntëmbëdhjetë vota 'për', asnjë 'kundër' dhe një abstenim, gjithsej njëzet (20) anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës, me shumicë të votave, e aprovoi 'Propozimin për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore, në tokë ndërtimore për subjektin afarist 'Xini Invest' në fshatin Harilaç' dhe mori:

V E N D I M

Aprovohet Propozimi Nr. 250, i datës 09.06.2017, për: 'Lejimin e ndërrimit të destinimit nga toka bujqësore në tokë ndërtimore për Ngastrën Kadastrale Nr. P-72514003-00001-0, arë e klasës së pestë, në sipërfaqe të përgjithshme prej 6664m², posedues nga qirambajtja për 99 vjet në emër të 'Xini Invest LLC', në Zonën Kadastrale Harilaç, evidentuar në certifikatën e pronës 14-463-13000, për ndërtimin e objekteve afariste depo për subjektet biznesore 'JYSK dhe KFC', të përfaqësuar nga Izedin Thaçi për subjektin afarist "Xini Invest LLC".

Pika e trembëdhjetë (13) - Propozim për ndryshimin e vendimit, Nr. 76, të datës 08.05.2017, për subjektin afarist 'Princi Kompani' në fshatin Harilaç.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim, 'Propozimin për ndryshimin e vendimit, Nr. 76, të datës 08.05.2017, për subjektin afarist 'Princi Kompani' në fshatin Harilaç'. Hap diskutimin.

Pas sqarimeve, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës e qiti në votim 'Propozimin për ndryshimin e vendimit, Nr. 76, të datës 08.05.2017, për subjektin afarist 'Princi Kompani' në fshatin Harilaç'.

U votua me: tetëmbëdhjetë vota 'për', asnjë 'kundër' dhe dy abstenime, gjithsej njëzet (20) anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës, me shumicë të votave, e aprovoi 'Propozimin për ndryshimin e vendimit, Nr. 76, të datës 08.05.2017, për subjektin afarist 'Princi Kompani' në fshatin Harilaç' dhe mori:

V E N D I M

Aprovohet 'Propozimi për ndryshimin e pikës një të vendimit Nr. 76, të datës 08.05.2017', për lejimin e ndërrimit të destinimit nga zona pyjore gjelbëruese, në zone ndërtimore, sipas kërkesës Nr. 02.016-1666, të datës 25.01.2017, për Ngastren Kadastrale Nr. P-72514003-00779-5, sipërfaqe e përgjithshme prej 20000m², pronë private, me posedues nga qirambajtja për 99 vjet në emër të Istref (Sejdi) Elshani, në Zonën Kadastrale Harilaç, evidentuar në certifikatën e pronës 14-095-39002, për ndërtimin: 'e fabrikës për seleksionimin, ambalazhimin e plastikës, letrës, qelqit, asgjësimin - djegien e mbeturinave urbane, gomave, vajrave, mbetjeve medicinale e barnave me afat të skaduar për subjektin afarist 'Shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuara 'Princi Kompani', investitor Avni (Salih) Barani.

Pika e katërmëdhjetë (14) - Propozim për shqyrtimin e kërkesës për ndryshimin e etazhitetit nga banimi individual, në ndërtim të lartë në Fushë-Kosovë.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim, 'Propozimin për shqyrtimin e kërkesës për ndryshimin e etazhitetit nga banimi individual, në ndërtim të lartë në Fushë-Kosovë, duke e ndryshuar Planin Zhvillimor Komunal. Hap diskutimin.

Drejtori i PU: Edhe në këtë rast kërkohet të ndryshohet Plani Zhvillimor Komunal, dhe Planit Zhvillimor Urban të Fushë-Kosovës. e jo ndërrimi I destinimit, për blloqet e reja të banimit.

Pasi që diskutime tjera nuk pati, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës e qiti në votim 'Propozimin për shqyrtimin e kërkesës për ndryshimin e etazhitetit nga banimi individual, në ndërtim të lartë në Fushë-Kosovë, duke e ndryshuar Planin Zhvillimor Urban të Fushë-Kosovës'.

U votua me: tetëmbëdhjetë vota 'për', asnjë 'kundër' dhe dy abstenime, gjithsej njëzet (20) anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës, me shumicë të votave, e aprovoi 'Propozimin për shqyrtimin e kërkesës për ndryshimin e etazhitetit nga banimi individual, në ndërtim të lartë në Fushë-Kosovë, duke e ndryshuar Planin Zhvillimor Komunal' dhe mori:

V E N D I M

1. Për aprovimin e 'Propozimit Nr. 593, të datës 22.06.2017, për ndryshimin e Planit Zhvillimor Urban të Fushë-Kosovës, i aprovuar me vendimin Nr. 31, të datës 05.04.2012.
2. Me Planin Zhvillimor Urban 2004-2015, Planin Rregullues Urban 2004-2015, plotësimin e Planit Zhvillimor Urban, 2011-2021, blloqet ndërtimore C 25, C 24, C 23, C 22, C 20, C 19, C 18, C 17, C 15, C 16, C 15, C 4, C 5, C 6 dhe C 7 me destinim banim individual, ndryshohen në etazhitet për ndërtime të larta.
3. Hapësira e përgjithshme për blloqet e banimit të cekura në pikën dy (2) të vendimit, do të riprojektohen sipas Ligjit për Ndërtim 04/L-110 dhe sipas Rregullores për normat minimale teknike për ndërtesat e banimit në bashkëpronësi Nr. 03/2016.


Pika e pesëmbëdhjetë (15) - Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi pikën 'Të ndryshme', ftoi anëtarët e Kuvendit të Komunës që ta marrin fjalën, nëse kanë ndonjë çështje për diskutim.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës falënderoi të pranishmit për pjesëmarrje në mbledhje.
Mbledhja përfundoi në orën 13.20 minuta.

Procesmbajtës

Hasan Gjyrevci



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Dr.sc. Fadil Krasniqi

